



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0140
Data e Vendimit: 19.03.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) “NIKA Pro-ing” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri adaptimet e hapësirave ne ndërtesat qeveritare” me numër të prokurimit:214-25-3033-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve te Brendshme, Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit z.Ardian Behra me datën 18/03/2026, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e “NIKA Pro-ing” SH.P.K.me nr. të protokollit 2026/0140, e datës 06/03/2026, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit Ri adaptimet e hapësirave ne ndërtesat qeveritare, me numër të prokurimit: 214-25-3033-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve te Brendshme.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – Ministria e Punëve te Brendshme që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit Ri adaptimet e hapësirave ne ndërtesat qeveritare me numër të prokurimit: 214-25-3033-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 06.03.2026, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE “NIKA Pro-ing” SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit me Ri adaptimet e hapësirave ne ndërtesat qeveritareme numër të prokurimit: 214-25-3033-5-1-1, inicuar nga Ministria e Punëve te Brendshme në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimi të ankesave pas pranimi të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 06.03.2026 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës se pas ekzaminimit të shkresave qe i keni bashkangjitur ne platformë OSHP, ka konstatuar se nuk keni kryer pagesën siç parashihet ne paragrafin 2 te nenit 69 te rregullores 001/2022 te prokurimit publik. citojmë nenin 69.2 “Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 200 Euro dhe jo më shumë se 10, 000 Euro”. andaj luteni që afatin e mbetur te na e përcjellin dëshminë lidhur me pagesën **në të kundërtën Ankesa do të refuzohet.** Për të cilën OE ankues “NIKA Pro-ing” SH.P.K. lidhur me e-mailin e dërguar nuk ka kthyer përgjigje.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “NIKA Pro-ing” SH.P.K.e datës 06.03.2026 (protokoll 0140/2026), për aktivitetin e prokurimit me titull Ri adaptimet e hapësirave ne ndërtesat qeveritare me numër të prokurimit: 214-25-3033-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Ministria e Punëve te Brendshme, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Ministria e Punëve te Brendshme që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit Ri adaptimet e hapësirave ne ndërtesat qeveritare, me numër të

prokurimit: 214-25-3033-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Kryesuesi i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: